

GJUKATA E QARKUT NË MITROVICË / MITROVICA

P No. 84/08

31 Mars 2011


NË EMËR TË POPULLIT

GJUKATA E QARKUT NË MITROVICË / MITROVICA, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX -it Klaus Jung, kryetar, dhe Christine Lindemann-Proetel dhe Hajnalka Veronika Karpati anëtarë , me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Anu Juho si procesmbajtëse në lëndën penale kundër:

HYRJET ISLAMIT, i akuzuar për Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) e Kodit Penal të Kosovës (KPK) [pika I e aktakuzës], Prodhimi dhe Përpunimi i Paautorizuar i Narkotikëve të Rrezikshëm dhe i Substancave Psikotropike në kundërshtim të Nenit 230 Paragrafi (1) i KPK [pika II.1 e aktakuzës] dhe Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi (2) i KPK [pika II.2 e aktakuzës], dhe

BASHKIM IMERI, i akuzuar për Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) e (KPK) [akuza I], Prodhimi dhe Përpunimi i Paautorizuar i Narkotikëve të Rrezikshëm dhe i Substancave Psikotropike në kundërshtim të Nenit 230 Paragrafi (2) i KPK [pika III e aktakuzës],

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor gjyqësor të hapur për publikun më 30 Mars 2011, në prani të të Akuzuarit Hyrjet Islami, Avokatit të tij Mbrojtës Bashkim Mehana, të Akuzuarit Bashkim Imeri, Avokatit të tij Mbrojtës Jetullah Mehaj dhe në prani të Prokurorit Publik të EULEX-it Adebayo Kareem, pas pranimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë lidhur me Pikën I, Pikën II 1 dhe Pikën III të aktakuzës në seancën e shqyrtimit kryesor gjyqësor të mbajtur më 30 Mars 2011, pas konsultimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 30 Mars 2011, me datën 31 Mars sipas Nenit 392 Paragrafi (1) i KPPK, shpalli publikisht dhe në prani të palëve të akuzuara, Avokatëve të tyre Mbrojtës, dhe Prokurorit Publik të EULEX-it, këtë



AKTGJYKIM


I.
I Akuzuari

HYRJET ISLAMI, pa nofkë, data e lindjes 18.7.1977, i lindur në Mitrovicë, emri i babës Behram, emri i nënës Hana Selmani, me banim në Mitrovicë, Rr.Shefq Ahmeti – 61, Shqipëtar i Kosovës, i cili punon si riparues i veturave, i martuar, dy fëmijë,

shpallet

FAJTOR

A. - sepse me datën 21 Maj 2008 rreth orës 15:30, duke vepruar në grup, në parkingun e Marketit EMONA në Vushtrri/Vučitrn, ka shpërndar pa autorizim substancën narkotike të rrezikshme-marihuanë me qëllim që ta shes atë, ashtu që pas takimit që kishin patur i pandehuri Bashkim Imeri dhe Berat Krasniqi me blerësin e quajtur Genc në Lagjën Dardani, përkatësisht tek kafenetë Santea, ata ishin pajtuar që shitjen ta bënin tek Marketi EMONA. Kur arritën te Marketi EMONA, Berat Krasniqi dhe Bashkim Imeri u takuan prap me Gencin dhe Genci u dha të pandehurit 1800 EURO, që ai t' i sillte dy kilogram marihuanë. Pastaj Bashkim Imeri kontaktoi Hyrjet Islamin në telefon, jo më vonë se pesë minuta, pasi kishin marrë një taksì,, Hyrjet Imeri dhe Samed Sylejmani arritën në t Restorant Emona. Pastaj Samed shfrytëzoi të njejtin taxi që të shkojë tek Ndërtesa e Kuvendit Komunal në Mitrovicë/Mitrovica, doli nga vetura dhe morri një çantë të zeze nga njerëz të panjohur, në të cilën kishte dy kilogram substancë narkotike (marihuanë) dhe 6 qese plastike me peshë 22,2 gram. Duke shfrytëzuar të njejtin taxi, Samed u kthye te Restoranti EMONA në Vushtrri/Vučitrn, dhe dorëzoi çantën në të cilën kishte narkotikë të Pandehurit Hyrjet Islami, i cili ia përcolli atë blerësit Genc, nga i cili kishte marrë 1800 EURO. Policia intervenoi menjëherë gjat shkëmbimit dhe kapi të pandehurit. Policia konfiskoi dy kilogrsam dhe 6 qese të vogla plastike me marihuanë nga i Pandehuri Hyrjet Islami dhe 3 qese të vogla plastike me marihuanë nga i Pandehuri Bashkim Imeri.



Duke vepruar kështu, i Akuzuari Hyrjet Islami ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale

A. Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) i KPK

B. - sepse më 21 Maj 2008 rreth orës 15:30 i Akuzuari Hyrjet Islami me vete kishte një armë Pistoletë COLT 7.65 mm, me numër serik 42340, prodhuar në Gjermani, me pesë fyshek, në parkingun e Marketit EMONA në Vushtri/Vuçitrn,

Duke vepruar kështu, i Akuzuari Hyrjet Islami ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale


B. Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi (2) i KPK

PRANDAJ, i Akuzuari **HYRJET ISLAMI**

DËNOHET

- me 3/tri/ vjet burgim për veprimin kriminal Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike
- me 1/një/vit burgim për veprimin kriminal Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve

Dënimi unik përcaktohet në 3/tri/vjet e 6/ghashtë/muaj burgim, në pajtim me Nenin 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) pika ii) e KPK.



Koha e kaluar në paraburgim nga data 21 Maj 2008 deri më 10 Shtator 2008 dhe në arrest shtëpiak nga data 10 Shtator 2008 deri më 03 Korrik 2009 do t' i llogariten në dënimin e shqiptuar sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

I Akuzuari

BASHKIM IMERI, nofka Bizha, data e lindjes 25.8.1981, i lindur në Prishtinë, emri i babës Idriz, emri i nënës Mihrije Zhegrova, me banim në Rr. "Vllezërit Frashëri" –9, Vushtrri, Shqipëtar i Kosovës, punon si staf i sigurimit në disko dhe bare nate, pa fëmijë, i gjendjës mesatare ekonomike

shpallet

FAJTOR

Sepse më 21 Maj 2008 rreth orës 15:30, duke vepruar në grup, në parkingun e Marketit EMONA në Vushtrri/Vuçitrn, ka shpërndar pa autorizim substancën narkotike të rrezikshme-marihuanë me qëllim që ta shes atë, ashtu që pas takimit që kishin patur i pandehuri Bashkim Imeri dhe Berat Krasniqi me blerësin e quajtur Genc në Lagjën Dardani, përkatësisht tek kafenetë Santea, ata ishin pajtuar që shitjen ta bënin tek Marketi EMONA. Kur arritën te Marketi EMONA , Berat Krasniqi dhe Bashkim Imeri u takuan prap me Gencin dhe Genci i dha të pandehurit 1800 EURO, që ai t 'i sillte dy kilogram marihuanë. Pastaj Bashkim Imeri kontaktoi Hyrjet Islamin në telefon, jo më vonë se pesë minuta, pasi kishin marrë një taksì,, Hyrjet Imeri dhe Samed Sylejmani arritën në Restorat Emona. Pastaj Samed shfrytëzoi të njejtin taxi që të shkojë tek Ndërtesa e Kuvendit Komunal në Mitrovicë/Mitrovica, doli nga vetura dhe mori një çantë të zezë nga njerëz të panjohur, në të cilën kishte dy kilogram substancë narkotike (marihuanë) dhe 6 qese plastike me peshë 22,2 gram. Duke shfrytëzuar të njejtin taxi, Samed u kthye te Restorani EMONA në Vushtrri/Vuçitrn, dhe dorëzoi çantën në të cilën kishte narkotikë të Pandehurit Hyrjet Islami, i cili ia përcolli atë blerësit Genc, nga i cili kishte marrë 1800 EURO. Policia intervenoi menjëherë gjat shkëmbimit dhe kapi të pandehurit. Policia konfiskoi dy kilogrsam dhe 6 qese të vogla plastike me marihuanë nga i

Pandehuri Hyrjet Islami dhe 3 qese të vogla plastike me marihuanë nga i Pandehuri Bashkim Imeri.

Duke vepruar kështu, i Akuzuari Bashkim Imeri ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale

Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) i KPK

PRANDAJ, i Akuzuari **BASHKIM IMERI**

DËNOHET

- Me 1/një/vit e 4/katër/ muaj burgim për veprimin kriminal Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike sipas Nenit 67 Paragrafi (1) pika ii).

Koha e kaluar në paraburgim nga data 21 Maj 2008 deri më 23 Shtator 2009 do t' i llogariten në dënimin e shqiptuar sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

II.

Akuza për veprën penale Prodhimi dhe Përpunimi i Paautorizuar i Narkotikëve të Rrezikshëm dhe i Substancave Psikotropike në kundërshtim të Nenit 230 Paragrafi (1) i KPK [pika II.1], kundër të Akuzuarit **HYRJET ISLAMI, REFUZOHET**, pas tërheqjes së akuzës nga Prokurori Publik i EULEX -it, në pajtim me Nenin 389 pika i) e KPPK.

III

Akuza për veprën penale Prodhimi dhe Përpunimi i Paautorizuar i Narkotikëve të Rrezikshëm dhe i Substancave Psikotropike në kundërshtim të Nenit 230 Paragrafi (2) i

KPK [pika III], kundër të Akuzuarit **BASHKIM IMERI, REFUZOHET**, pas tërheqjes së akuzës nga Prokurori Publik i EULEX -it, në pajtim me Nenin 389 pika i) e KPPK.

IV Pistoleta COLT 7.65 mm, me numër serik 42340, prodhuar në Gjermani, me pesë fyshek konfiskohet në pajtim me Nenin 60 Paragrafi (1) dhe Nenin 328 Paragrafi (5) i KPK.

V Dy kilogram marihuanë, 6 qese plastike me 22.2 gram marihuanë, tri qese plastike me 3.7 gram, 3.6 gram dhe 3.1 gram marihuanë dhe njëzet fara të marihuanës konfiskohen në pajtim me Nenin 60 Paragrafi (1) dhe Nenin 229 të KPK.

VI 1800 Eurot e marrura nga Hyrjet Islami konfiskohen në pajtim me Nenin 60 Paragrafi (1) i KPK dhe Nenin 494 të KPPK.


Arsyetim

A. Historia Procedurale

Aktakuza PP nr. 66/08 e parashtruar në Gjykatën e qarkut në Mitrovicë nga Prokurori Publik Jusuf Mejzini më 19 Qershor 2008, akuzon

- Hyrjet Islamin për Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) e KPK [pika I], Prodhim dhe Përpunim të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim të Nenit 230 Paragrafi (1) i KPK [pika II.1] dhe Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi (2) i KPK [pika II.2]

- Bashkim Imerin për Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) e (KPK) [akuza I], Prodhim dhe Përpunim



të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim të Nenit 230 Paragrafi (2) i KPK [pika III],

- Isamed Sylejmanin për Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika 1 e KPK [pika I]

- Berat Krasniqin për Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) e KPK [pika I]

Gjyqtarët e EULEX-it e morën përsipër rastin më 2 Gusht 2009. Aktakuza është konfirmuar nga Gjyqtari i EULEX-it Nikolay Entchev kundër Hyrjet Islamit dhe Bashkim Imerit më 22 Nëntor 2010. Gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës hodhi poshtë Aktakuzën kundër Berat Krasniqit dhe rëndoi aktakuzën kundër Isamed Sylejmanit për shkak të mungesës së tij.

Shqyrtimi kryesor gjyqësor filloi më 30 dhe 31 Mars para trupit gjykues të gjyqtarëve të EULEX-it. Prokurori Publik i EULEX-it Adebayo Kareem ndryshoi akuzën kundër Hyrjet Islamit Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328, *Paragrafi (2)* i KPK [pika II.2]. Hyrjet Islami dhe Bashkim Imeri pranuan fajësinë për akuzën në pikën I dhe Hyrjet Islami për akuzën në pikën II.2. Prokurori i EULEX-it Adebayo Kareem tërhoqi akuzën në pikën II.1 kundër Hyrjet Islamit dhe akuzën në pikën III kundër Bashkim Imerit. Trupi gjykues pranoi pranimet e fajësisë dhe aktgjykimi u shpall gojarisht më 31 Mars.

B. Kompetenca e Gjykatës

Sipas Nenit 23 Pika 1) i) e KPPK, Gjykatat e Qarkut janë kompetente për të gjykuar lëndët penale që përfshijnë akuzat për të cilat ligji lejon shqiptimin e dënimit penal prej së pakut pesë vjet burgim. Sipas Nenit 27 Paragrafi (1) i KPPK, kompetenca territoriale i takon gjykatës së qarkut ku pretendohet se është kryer vepra penale.

Akuza rënduese kundër të Akuzuarit Hyrjet Islami dhe Bashkim Imeri është Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) e (KPK) , e cila lejon shqiptimin e dënimit prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim. Aktakuza pretendon se të Akuzuarit kanë kryer veprimet kriminale në Vushtrri, që shtrihet në Qarkun e Mitrovicës.

Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/a është orgsan kompetent juridik për të shqyrtuar procedurën penale.

Më 2 Gusht 2010, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka ushtruar të drejtën e saj që tua caktoj gjyqtarëve të EULEX-it rastet të cilat bien nën kompetencën shtesë të Gjyqtarëve të EULEX-it sipas Nenit 3.3 të “Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Ndarjen e Lëndëve për Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë” dhe ua ka caktuar këtë lëndë Gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë/a.

C. Provat

Trupi Gjykues është i kënaqur që marrëveshja për pranimin e fajësisë është arritur me vetëdije dhe në mënyrë vullnetare, pas shumë konsultimeve me Avokatët e tyre Mbrojtës, në pajtim me Nenin 359 Paragrafi (20) lidhur me Nenin 315 Paragrafi 91) i KPPK. Trupi Gjykues është gjithashtu i kënaqur që marrëveshja për pranimin e fajësisë mbështet nga faktet e rastit të cekura më lartë, në pajtim me Nenin 315 Paragrafi (1) Nënparagrafi (3). Shkresat e lëndës përmbajnë raportet policore që me datën 21.5.2008, Policia e Kosovës kishte zbuluar të Marketi në Vushtrri dy kilogram të lëndë bimore me ngjyrë të gjelbërt. Kjo lëndë bimore me ngjyrë të gjelbërt është analizuar më 15 Shtator 2008 nga Laboratori Qendror Kriminalistik dhe është vërtetuar se është Cannabis i cili përmban tetrahydrocannabinol (THC).

D. Kualifikimet Ligjore

1. Kualifikimet Ligjore të veprimeve të palëve të akuzuara

Hyrjet Islami dhe Bashkim Imeri janë akuzuar për Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike siç kodohet me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) e e Kodit Penal të Kosovës (KPK), i cili thotë:

Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.

Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2, ose 3 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet kur:

“Narkotikë të rrezikshëm dhe substanca psikotropike” përkufizohen në Nenin 107 Paragrafi (29) i KPK si substanca të cekura në “Gazetën zyrtare të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë”, nr. 70/78, 14/81, 39/82, 28/85, 10/87, 53/88, 2/89. Vendimi mbi Krijimin e Listës së Narkotikëve të publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 70/78 e numron “Kanabisin (Kërpi Indian)” si narkotik (pika nr. 69). Definicioni i ngjajshëm jepet në “Ligjin për Barnat Narkotike, Substanca Psikotropike dhe Prekursorë”. Sipas Nenit 9.1 Bimët, medikamentet narkotike, substancat psikotropike dhe preparatet dhe prekursorët e tyre bazuar në këtë Ligj janë dhënë në Tabelën I, II, III dhe IV. Tabela I ka të bëjë me bimët, medikamentet narkotike dhe substancat psikotropike të rrezikshmërisë së lartë të cilat nuk përdoren në mjekësi dhe veterinar, veprimtaria e të cilave ndalohet në Kosovë. Kanabisi dhe rrëshira e Kanabisit si dhe ekstraktet dhe tretësirat e kanabisit, emri kimik Kërpi Indian dhe rrëshira nga Kërpi Indian përkufizohen si narkotikë.

Nga Raportet Policore dhe nga Analiza e Laboratorit Qendror Kriminalistik konfirmohet se Hyrjet Islami dhe Bashkim Imeri kanë shpërndarë narkotik dhe substancë psikotrope – kanabis (marihuanë) e cila përmban THC me qëllim të shitjes pa patur autorizim për ta bërë këtë.

Hyrjet Islami është akuzuar për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paaautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi (2) i KPK [pika II.2 e aktakuzës]. Hyrjet Islami kishte me vete një pistoletë COLT 7.65 mm, me numër serik 42340, prodhuar në Gjermani, me pesë fyshek në të.

Arma përkufizohet në Nenin 107 Paragrafi (28) i KPK; termi armë nënkupton mjetin e prodhuar që përdoret ose është i përshtatshëm të përdoret për të shkaktuar lëndime trupore. Në bazë të raporteve dhe analizës policore pistoletë COLT përkufizohet si armë.


Prandaj, elementet ligjore të veprave penale janë plotësuar.

E. Dënimi

Me rastin e shqiptimit të dënimit penal Gjykata duhet ta ketë parasysh si qëllimin e përgjithshëm të dënimit – do të thotë të parandalojë aktivitetet e rrezikshme shoqërore dhe frenojë të tjerët që të mos kryejnë veprime të ngjajshme kriminale, ashtu edhe qëllimin specifik- ta parandalojë kryerësin që të mos përsërisë veprën. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit, Gjykata duhet t' i vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, sipas Nenit 64 Paragrafi i KPK.

Gjykata mori në konsiderim si rrethanë lehtësuese faktin se Hyrjet Islami dhe Bashkim Imeri pranuan veprat penale dhe janë deklaruar fajtorë. Asnjëri prej tyre nuk ka qenë më parë i dënuar. Gjykata gjithashtu supozoi në favor të të akuzuarëve koncentrimin e ultë të THC në marihuanën e konfiskuar (meqë koncentrimi real nuk dihej). Pastaj, policia kishte intervenuar menjëherë duke konfiskuar dy kilogram marihuanë dhe kështu, droga nuk kishte arritur në tregun e konsumuesëve.

Sa i përket Bashkim Imerit, Gjykata mori në konsiderim se ai vetë ishte konsumues i marihuanës dhe se nuk ka pritur ndonjë përfitim personal relevant.



Për veprimin kriminal Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) e KPK, ligji parasheh dënimin me gjobë dhe me burg prej tri deri në pesëmbëdhjetë vjet. Hyrjet Islamit Gjykata i shqiptoi dënimin prej tri vjet burg për këtë vepër penale.

Për veprimin kriminal Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi (2) i KPK ligji parasheh dënimin me burg prej një deri në tetë vjet. Hyrjet Islamit Gjykata i shqiptoi dënimin prej një vjet burg për këtë vepër penale.

I Akuzuari Hyrjet Islami ka kryer dy veprime kriminale. Sipas rregullave të llogaritjes së dënimit të përbërë, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se secili dënim individual, por jo aq i lartë sa shuma e dënimit të përshkruar. Trupi gjykues i shqiptoi atij dënimin unik prej tri vjet e gjashtë muaj burg sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe (2) pika ii) e KPK.

Sa i përket Bashkim Imerit, sipas Nenit 66 të KPK gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufijtë e paraparë me ligj në rastet kur ligji parasheh që dënimi i kryerësit mund të zbutet apo kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet duke shqiptuar dënim edhe më të butë. Sipas Nenit 67 Paragrafi (1) pika i) e KPK kur ekzistojnë kushtet e parapara nga Neni 66 e Kodit, gjykata e zbut dënimin brenda këtyre kufijëve, nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët e dënimit me burgim prej së paku tri vjet, dënimi mund të zbutet deri në një vit burgim;. Gjykata mendon se rrethanat e lartcekura janë posaçërisht lehtësuese siq kërkohet me Nenin 66 pika ii) e KPK, gjë që i mundëson trupit gjykues që ta shqiptojë dënimin më të butë se sa minimumi i paraparë me ligj në Nenin 67 të KPK. Gjykata i shqiptoi Bashkim Imerit dënimin prej një vjet e katër muaj burgim për këtë vepër penale Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje të Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike në kundërshtim me Nenin 229 Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (4), pika i) e KPK

I Akuzuari Hyrjet Islami ka qenë në paraburgim nga data 21 Maj 2008 deri më 10 Shtator 2008 dhe në arrest shtëpiak nga data 10 Shtator 2008 deri më 03 Korrik 2009. I Akuzuari Bashkim Imeri ka qenë në paraburgim nga data 21 Maj deri më 20 Qershor 2008, nga 25 Qershor 2008 deri më 25 Gusht 2008, nga 25 Gusht deri më 25 Tetor 2008, dhe prej datës 23 Korrik 2009 deri më 23 Shtator 2009 dhe në arrest shtëpiak nga data 20 Qershor 2008 deri më 20 Korrik 2008, nga 17 Shtatori 2008 deri më 17 Tetor 2008, nga 17 Tetori deri më 17 Dhjetor 2008, nga 17 Dhjetori deri më 17 Shkurt 2009, nga 17 Shkurti deri më 17 Prill 2009, nga 17 Prilli deri më 17 Qershor 2009 dhe nga 17 Qershori 2009 deri më 17 Gusht. Këto periudha do të llogariten në dënimet e shqiptuara me burg sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/a

P. nr. 84/2008

Përgaditur në gj. angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetari T. Gjykues
Klaus Jung

Anëtar i T. Gjykues
Christine Lindemann-Proetel

Hajnalka Veronika Karpati

Zyrtare Ligjore
Anu Juho

Këshillë Juridike

Personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/a në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh nga data e pranimit të kopjes së aktgjykimit.

